



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.227/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Afijete Sada Glllogjani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 16.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për Kryetar të Mamushës nga subjektit politik Kosova Demokratik Turk Patrisi (KTAP) ka publikuar fotografi në rrjetin social facebook, në të cilin ka përdorur pamje të fëmijës nën moshën 18 vjeç. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë veprim kandidati për kryetar të Komunës së Mamushës ka shkelur Kodin e Mirësjelljes dhe deklarin e institucionit të Avokatit të Popullit për mospërdorimin e fëmijëve në fushata elektorale-politike. Parashtruesi i ankesës konsideron se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së që ndalon përfshirjen e personave nën 18 vjet në fushat zgjedhore.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga faqja e Facebook të kandidatit për Kryetar të komunës së Mamushës, Arif Bytyc .

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik KTAP, të datës 17.10.2017, theksohet se veprimet e kërkuara për ndërmarrjen e masave sipas ankesës në fjalë lidhur me fotografit e publikuara në facebook i ka hequr të gjitha para protokollimit të ankesës e bërë nga organizata BIRN, konkretisht më datë 15.10.2017. I njëjti thekson se fotografitë e vendosura në profilin e tij

personal nuk ka qenë tendencë për përdorimin e fëmijëve për përfitime dhe angazhime në fushatë dhe kjo vërtetohet me tërheqjen e tyre brenda dy orëve.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe provat e bashkangjitura erdhe në përfundim se pretendimet në ankesë janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi për faktin se nga fotografat që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se ka elemente të fushatës zgjedhore me fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe se nga kjo nuk mund të konstatohet se fëmijët e publikuar në Facebookun personal të personit në fjalë nuk mbajnë elemente të fushatës zgjedhore dhe nuk mund të konstatohet se është zhvilluar tubim elektorale .

Andaj, paneli erdhi në përfundim se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 227/2017 më datën 17.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.